



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/135  
Datë: 20.03.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022 dhe Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 01/60 të datës 05.02.2022 dhe Vendimin Nr.17/121 të datës 25.01.2023, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 mars 2023, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 7,278,747.59 €, (shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e katër dhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë e nëntë cent), për zbatimin e masës 3.7 - Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213 në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11313, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet sipas këtij Vendimi përdoren për qëllim të subvencionimit të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë, me qëllim të uljes së ndikimit të tarifave të energjisë, e cila pastaj reflektohet edhe në faturat e konsumatorëve.
4. Kushtet dhe kriteret e shfrytëzimit të mjeteve nga pika 1. e këtij Vendimi përcaktohen me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 21/94 të datës 24 gusht 2022.
5. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës.
6. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë, për zbatimin e këtij Vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


## Arsyetim

Sipas kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, në mënyrë që të përmbushet zotimi i Qeverisë sipas Vendimit Nr. 01/60 të datës 5 shkurt 2022, nevojitet që shuma e mbështetjes të ketë vlerën 90 milionë euro pa përfshirë TVSh-në prej 8%. Kjo nënkupton se shuma e subvencionimit me gjithë TVSh duhet të jetë 97.2 milionë euro.

Në vitin fiskal 2022, gjithsej pagesa në emër të këtij detyrimi janë bërë 64,601,252.41 €, ndërsa në vitin aktual 2023 janë ndarë edhe 25,320,000.00 € tjera për këtë qëllim, që e sjell totalin e mjeteve në 89,921,252.41 €.

Në mënyrë që të përmbushet detyrimi i plotë, sipas ME-së nevojitet ndarja e edhe 7,278,747.59 € tjera, të cilat bashkë me mjetet e lira nga ndarjet e mëhershme, do të përmbushnin në tërësi detyrimin prej 97.2 milionë euro.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë